



BACHELOR MENAXHIM BIZNESI

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Po kërkon një diplomë që të çon drejt punës reale?

Bachelor në **Menaxhim Biznesi – FEA**, i ndërtuar në bashkëpunim me **Universitetin BOKU**, bashkon teorinë me praktikën dhe përgatit profesionistë që kuptojnë si funksionon realisht një biznes.

Programi me fokus Agrobiznesin dhe Turizmin Rural, dy sektorë strategjikë në rritje që krijojnë vende pune dhe zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri.

Studentët fitojnë njohuri në menaxhim, marketing, financë dhe sipërmarrje, si edhe aftësi praktike për menaxhimin e bizneseve moderne dhe zinxhirëve të vlerës.

Më pak teori, më shumë treg dhe mundësi.


Ndërto të ardhmen aty ku ka potencial real.

Diplomë që njihet ndërkombëtarisht



Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në Menaxhim Biznesi përgatit profesionistë të aftë në zhvillimin e kompetencave menaxheriale, lidhshirë dhe aftësive ndërpersonale, kompetencave sipërmarrëse në sektorin privat dhe publik si dhe në promovimin e praktikave të qëndrueshme dhe inovacionit teknologjik. Njohuritë e fituara i përgatisin studentët për të operuar me sukses përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit dhe marketingut, deri te konsumatori final.



Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit përgatiten për të punuar si:

- **Menaxher në biznese dhe agrobiznese** moderne, me fokus në performancë të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik.
- **Konsulent biznesi**, i aftë për menaxhim operativ, hartim projektsh zhvillimi dhe sigurim mbështetjeje financiare në bashkëpunim me institucione publike dhe private.
- **Menaxher në biznese të turizmit**, agroturizmit dhe turizmit rural, me aftësi në marketing, strategji shitjeje dhe bashkëpunim me komunitetin dhe tregjet.
- **Konsulent/Ekspert** në institucione, organizata dhe OJF të lidhura me turizmin dhe zhvillimin rural.



Jonida Gjoni

Drejtoreshë Finance, MEGATEK

“Njohuritë ekonomike dhe financiare më udhëheqin drejt vendimeve të zgjuara. Studimet dhe përvoja praktike më kanë formuar të jem e disiplinuar, e përgatitur për sfida dhe e fokusuar në arritjen e synimeve profesionale.”



Vjola Elezi

Specialiste njësi IPA/IPARD,
Ministria e Financave

“Njohuritë mbi politikat bujqësore, zhvillimin rural dhe financimet e BE-së janë baza e punës sime. Me aftësi analitike dhe menaxheriale, kontribuoj në administrimin e programeve IPA/IPARD, duke siguruar përdorim të qëndrueshëm të fondeve sipas standardeve europiane.”



Kristi Marku

Shoqëruese Fluturimi

“Studimet në Menaxhimin e Turizmit Rural kanë formuar një perspektivë të plotë mbi turizmin si mjet zhvillimi dhe mbështetjeje komunitetesh. Me 7 vite përvojë dhe bazë të fortë akademike, ndërthur teorinë me praktikën në menaxhim, marketing dhe zhvillim destinacionesh.”



Anxhelo Malushi

Specialist, Sektori i Rinisë, Bashkia
Tiranë

“Prej 5 vitesh angazhohem në fushën e turizmit dhe rinisë, në sektorin privat dhe institucionet vendore, duke kontribuar në zhvillimin lokal dhe përfshirjen e të rinjve. Studimet në Menaxhimin e Turizmit Rural kanë formësuar angazhimin tim ndaj turizmit të qëndrueshëm dhe fuqizimit të komuniteteve lokale.”

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- **Menaxhim dhe lidership** – Drejtim efikas i bizneseve bujqësore, agrobizneseve dhe njësisve turistike rurale; punë në ekip dhe komunikim profesional.
- **Marketing dhe shitje** – Hartim strategjish promovimi për produkte ushqimore dhe shërbime turistike.
- **Analizë dhe vendimmarrje** – Vendime të bazuara në të dhëna financiare, teknike dhe organizative.
- **Projektim dhe menaxhim Biznes turistike, agroturistike dhe turizmi rural**

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Matematikë, Statistikë,
Informatikë,
Prodhim Bimor & Shtazor,
Menaxhimi i Tokës dhe
Ujit

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Mikro - Makroekonomi,
Menaxhim dhe Sipërmarrje,
Marketing, Drejtim
Financiar, Menaxhim i
Burimeve Njerëzore,
Administrim dhe Menaxhim
Publik, Menaxhim Risku
dhe Sigurime

TË TJERA

Vlerësim Mjedisi,
Teknologji të Përpunimit
Agroushqimor,
Infrastrukturë Cilësie,
Menaxhim i Makinerive
Bujqësore, Vlerësim Sensorial
i Ushqimeve dhe Pijeve

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

Mundësi Punësimi:

- Menaxher biznesesh dhe agrobiznesesh
- Konsulent biznesi dhe financash për sektorin privat dhe publik
- Specialist marketingu dhe shitjeje në zinxhirin agroushqimor
- Menaxher marketingu dhe shitjeje në zinxhirin agroushqimor
- Analist performance dhe planifikimi strategjik
- Menaxher në turizëm, agroturizëm dhe turizëm rural
- Angazhim në institucione arsimore dhe kërkimore

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në Menaxhim Biznesi

Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

Kredite

180 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

120 studentë

Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Të diplomuarit mund të vazhdojnë në ciklin e dytë Master Shkencor ose Master Profesional në fusha të biznesit, turizmit, marketingut dhe teknologjisë.

Fakulteti ofron programet: Menaxhim Biznesi, Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital, Turizëm i Qëndrueshëm dhe Zhvillim Rural, si dhe profile të tjera në Ekonomi, Informatikë dhe Financë – Kontabilitet.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti_bujqesor_tiranes
fea_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit - UBT- faqja zyrtare

Për jetën dhe të ardhmen...